



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister**

**Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics**

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, **Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:**

**Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta**

Emri i Institucionit	<b>Agjencia e Statistikave të Kosovës</b>
Titulli i punës:	<b>Zyrtar për statistika ne zyrën rajonale në Gjilan</b>
Numri i referencës:	<b>ASK-DRA-001</b>
Tarifa e shërbimit:	<b>437.55 bruto</b>
Raporton te:	<b>Zyra rajonale në Gjilan</b>
Lloji i kontratës:	<b>Marrëveshje për Shërbime të Veçanta–(MSHV)</b>
Kohëzgjatja e kontratës:	<b>Gjashtë (6) muaj</b>
Orari i punës:	<b>I plotë</b>
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	<b>ASK- 1</b>

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Kryen plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin e Raporteve tremujore të çmimeve të prodhimit industrial
- Kujdeset për shpërndarjen, distribuimin dhe grumbullimin e raporteve në teren
- Bënë kontrollimin dhe analizën logjike të Raporteve tremujore të statistikave afatshkurtra të industrisë

- Kryen plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin e Raporteve tremujore të statistikave afatshkurtra të ndërtimtarisë,
- Kujdeset për shpërndarjen, distribuimin dhe grumbullimin e raporteve në teren,
- Bënë kontrollimin dhe analizën logjike të raportet tremujore të statistikave afatshkurtra të ndërtimtarisë ,
- Kryen grumbullimin, monitorimin dhe analizën logjike e çmimeve të konsumit të gjerë,
- Përgatit librin e Çmimeve të konsumit të gjerë mbreda afatit të paraparë dhe dërgon në sektorin e Çmimeve në ASK .
- Kujdeset për shpërndarjen, distribuimin materialit në teren, grumbullimin materialit nga njësit raportuese, kontrollimin dhe sistemimin e Raporteve të statistikave Vitale,
- Kryen grumbullimin, monitorimin analizën logjike të çmimeve të artikujve bujqësore,
- Përgadit librin e Çmimeve të bujqësisë mbreda afatit të paraparë,
- Udhëzon për plotësimin e formularëve të Raporteve të statistikave Vitale
- Bënë kontrollimin dhe analizën logjike të Raporteve të statistikave Vitale
- Zhvillon raporte të mira me responentët
- Kryen plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin e Çmimet Indeksit të ndërtimit
- Kujdeset për grumbullimin e raporteve nga tereni
- Bënë kontrollimin dhe analizën logjike të Çmimeve të Indeksit të ndërtimi
- Kryen anketat për të gjitha hulumtimet statistikore në nivel të rajonit të Gjilanit
- Me kërkesën e shefit të Zyrës rajonale, përcjell dhe monitoron personat e angazhuar në teren gjatë procesit te implementimit te projekteve të planifikuara nga ASK-ja .
- Raporton te Shefi i zyrës rajonale për dinamiken e aktiviteteve sipas agjendës që ka parashtruar Departamenti i ASK-ës

**Kualifikimi :** Diploma universitare –Fakulteti nga fushat ekonomike, shoqërore, juridike, apo të ngjashme.

**Përvoja e punës:** e preferueshme

**Kompetenca dhe aftësitë:**

- Njohja e kompjuterit (Word ,Excel, Outlook) ,
- Bashkëpunimi në mënyrë ekipore e nevojshme,
- Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore.
- Shkathësi në realizimin e punëve dhe detyrave sipas planit vjetor të zyrës rajonale
- Shkathësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;

**Agjencia e Statistikave të Kosovës,** mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarikë nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në ueb faqen e ASK-së.**

**Paraqitja e kërkesave:** Formularët për aplikim mund të merren në Arhivën e ASK-së, ose mund të tërhiqen nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës , Rr.,"Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë. **Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten:** Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit , në tel: 038- 20031149 , prej orës 08:00 - 16:00.